



TREVAT SHQIPTARE NË HARRESË

RAPORT MONITORIMI

Qershor 2024

QENDRESA QYTETARE

NED PARTNERI QYTETOR
PËR QËVERISJEN

www.qeverisja.qq.com.al



AUTOR
LORELA ALIA

Table of Contents

1. Hyrje	3
1. Historiku i Komunitetit Shqiptar në Rajon	4
2. Përkufizimi Terminologjik dhe Aspekti Ligjor mbi Komunitetin Shqiptar.....	5
3. Kushtet Aktuale të Komunitetit Shqiptar në Rajon	7
3.1. Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut	7
3.2. Shqiptarët në Mal të Zi.....	8
3.3. Shqiptarët në Serbi	9
4. Sfidat që përballet komuniteti shqiptar	11
4.1. Komuniteti shqiptar në RMV	12
4.2. Komuniteti shqiptar në Mal të Zi	14
4.3. Komuniteti shqiptar në Serbi.....	16
5. Roli i Shtetit Shqiptar në Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave dhe Identitetit Shqiptar në Rajon.....	20
6. PËRFUNDIMET.....	22
7. REKOMANDIMET	23
8. REFERENCAT	24

1. Hyrje

*'Persons belonging to national minorities have the right freely to express, preserve and develop their ethnic, cultural, linguistic or religious identity and to maintain and develop their culture in all its aspects, free of any attempts at assimilation against their will.'*¹

Ky raport synon të shqyrtojë gjendjen aktuale të komunitetit shqiptar në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë historikun e tij, aspektet ligjore dhe terminologjike, kushtet aktuale, por mbi të gjitha do të fokusohemi në sfidat e komunitetit shqiptar në Ballkanin Perëndimor dhe rolin e shtetit shqiptar në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe identitetit të komunitetit shqiptar, si dhe kërkesat që ky komunitet ka ndaj shtetit shqiptar.

Ne do të përdorim metodën cilësore të analizës së të dhënave, bazuar në burime të ndryshme dokumentare, prodhime shkencore (burime dytësore), raporte nga institucione të ndryshme ndërkombëtare (raportet e BE-se, DASH) dhe qeveria shqiptare, MEPJ², Agjencia Kombëtare e Diasporës dhe të dhëna të prodhuara në bazë të intervistave gjysmë të strukturuar për të realizuar një pasqyrim dhe analizim të sfidave që përballen këto komunitete në Ballkanin Perëndimor.

Në këtë raport, analizojmë komunitetin shqiptar në tre shtete, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbi. Përzgjedhja e këtyre tre shteteve është bazuar në prezencën e gjerë të këtij komuniteti dhe sfidat komplekse që ata përballen. Ky studim u dedikohet këtyre konteksteve për shkak të kufizimeve kohore dhe burimore të limituara.

¹ Document of the Copenhagen Meeting of the Conference on the Human Dimension of the CSCE. (n.d.). OSCE.

<https://www.osce.org/odihr/elections/14304>

² Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Kërkimi ynë do të ofrojë një analizë të thelluar të sfidave të identifikuara në çdo shtet dhe rekomandime për të përmirësuar situatën e komunitetit shqiptar në këto kontekste të ndryshme shtetërore.

1. Historiku i Komunitetit Shqiptar në Rajon

Komuniteti shqiptar ka një histori të gjatë dhe të ndërlikuar në rajon. Gjatë periudhave të ndryshme historike, shqiptarët janë përballur me sfida të mëdha, përfshirë luftrat ballkanike, ndarjet territoriale, dhe shpërnguljet e detyruara. Pas shpalljes së Pavarësisë së shtetit shqiptar, jashtë kufinjëve të shtetit tonë mbetën pjesa më e madhe e popullsisë shqiptare e cila vazhdon ende të mbetet një plagë e historisë sonë.

Pas Luftës së Dytë Botërore, ndryshimet politike dhe kufinj të rinj ndikuan ndjeshëm në shpërndarjen dhe statusin e komunitetit shqiptar. Në dekadat e fundit, sidomos pas rënies së komunizmit dhe konflikteve të viteve 1990 në Ballkan, shqiptarët kanë luftuar për njohjen e të drejtave të tyre dhe integrimin e plotë në shtetet ku jetojnë, ndonëse kjo ende vazhdon të mbetet një sfidë e papërmbytur edhe sot, sidomos për shqiptarët që jetojnë në Serbi, Mal të Zi dhe në Maqedoninë e Veriut.

Marrëveshja e Ohrit, e nënshkruar në vitin 2001³ ishte një ndër momentet më të rëndësishme për shqiptarët në Maqedoni duke garantuar përfaqësimin proporcional në institucionet shtetërore, zgjerimin e të drejtave për përdorimin e gjuhës shqipe, arsimimin në gjuhën amtare, si dhe fuqizimin e qeverisjes lokale për komunitetet shqiptare. Pavarësisht kësaj marrëveshje komuniteti shqiptar në Maqedoninë e Veriut vazhdon të përballë me shkeljen e të drejtave themelore.

³ Ministria e Arsimit dhe Shkencës. (2001). Marrëveshja e Ohrit. https://mls.gov.mk/images/laws/Marreveshja_e_Ohrit.pdf

Një moment i rëndësishëm për komunitetin shqiptar në Mal të Zi ishte miratimi i ligjit për përdorimin e simboleve kombëtare në vitin 2017.⁴ Ky ligj lejon përdorimin e lirë të flamurit kombëtar dhe simboleve të tjera shqiptare në aktivitete publike dhe private, duke njohur dhe respektuar kështu identitetin dhe kulturën e komunitetit shqiptar në këtë shtet. Komuniteti shqiptar në Mal të Zi ende përballet me sfida të shumta ekonomike, arsimore dhe të identitetit.

2. Përkufizimi Terminologjik dhe Aspekti Ligjor mbi Komunitetin Shqiptar

Terminologjia që përdoret për të përshkruar komunitetin shqiptar në rajon shpesh ndryshon sipas kontekstit dhe vendit. Termat më të zakonshëm përfshijnë "shqiptarë etnikë", "diaspora shqiptare" dhe "minoritet shqiptar". Çdo term ka implikime të ndryshme ligjore dhe sociale, varësisht nga shteti përkatës.

Nuk ka konsensus, se si të përkufizohet minoriteti. Përkufizimi më i përdorur është ai nga Kombet e Bashkuara i vitit 1979, i cili e përkufizon një minoritet si një grup numerikisht më i ulët ndaj pjesës tjetër të popullsisë së një shteti, anëtarët e së cilës kanë karakteristika etnike, fetare ose gjuhësore të ndryshme nga pjesa tjetër e popullsisë dhe tregojnë qoftë vetëm në mënyrë implicite, një ndjenjë solidariteti të udhehequr drejt ruajtjes së kulturës, traditave, fesë së tyre si dhe gjuhës.⁵ Në shtetet demokratike, të gjithë pjesëtarët e minoriteteve gëzojnë të drejtat e tyre të garantuara. Të drejtat e minoriteteve janë një grup të drejtash të garantuara për të siguruar që grupet etnike, kulturore, fetare dhe gjuhësore të vogla të mund të ruajnë identitetin e tyre dhe të marrin pjesë plotësisht në jetën publike dhe private. Këto

⁴ Skupština Crne Gore. (2017). Law on the symbols of Montenegro. <https://www.skupstina.me/uploads/documents/zakoni/2017/82-18-Zakon-o-simbolima-Crne-Gore.pdf>

⁵ OKB, (1979). Declaration on the Rights of Persons Belonging to National or Ethnic, Religious and Linguistic Minorities. <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/minorities.aspx>

të drejta janë të përfshira në një sërë dokumentesh ndërkombëtare dhe kombëtare.

Siç u përmend më sipër në aspektin ligjor, statusi i komunitetit shqiptar ndryshon nga një vend në tjetrin. Në disa shtete, shqiptarët gëzojnë të drejta të plota si minoritet etnik, përfshirë përdorimin e gjuhës shqipe në institucione publike dhe arsim. Në vende të tjera, këto të drejta janë të kufizuara dhe shpesh të kontestuara, duke krijuar tensione dhe sfida të vazhdueshme për komunitetin shqiptar.

Legjislacioni shqiptar që lidhet me mbrojtjen dhe mbështetjen e komuniteteve shqiptare jashtë territorit të Shqipërisë përbëhet nga një sërë ligjesh dhe rregullash që synojnë të forcojnë lidhjet me diasporën dhe të mbrojnë të drejtat e shqiptarëve në rajon. Disa nga elementet kryesore të këtij legjislacioni: Neni 8 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve që jetojnë jashtë kufinjve të vendit. Ligji Nr. 16/2018 "Për Diasporën" vendos politikën për bashkëpunimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në diasporë.⁶ Kjo përfshin promovimin e kulturës dhe gjuhës shqipe, si dhe krijimin e strukturave institucionale si Agjencia Kombëtare për Diasporën dhe Këshilli Koordinues i Diasporës për të koordinuar dhe mbështetur komunitetet shqiptare në të gjithë botën. Ambasadat dhe konsullatat shqiptare kanë rol të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në nivel diplomatik.

Ligjet dhe mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve shqiptare shpesh ekzistojnë në teori pasi në praktikë, zbatimimi dhe impakti i tyre në përmirësimin e jetës së përditshme të shqiptarëve është i kufizuar. Kjo përfshin mungesën e zbatimit të ligjeve për barazinë, diskriminimin dhe përdorimin e gjuhës shqipe në arsim dhe administratën e shteteve përkatëse.

⁶ Republika e Shqipërisë. (2018). Ligji Nr. 16/2018 "Për Diasporën". Fletorja Zyrtare, 25, 1585-1592.


3. Kushtet Aktuale të Komunitetit Shqiptar në Rajon

Komuniteti shqiptar në rajon përballet me sfida të ndryshme, të cilat variojnë nga integrimi ekonomik dhe social deri te ruajtja e identitetit kulturor dhe gjuhësor.

3.1. Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut

Në Maqedoninë e Veriut, shqiptarët përbëjnë 24.3% siaps Censit të vitit 2021, (Figura 1) dhe ky numër ka ardhur në rritje që nga viti 1981. Komuniteti shqiptar gëzon disa të drejta sipas Marrëveshjes së Ohrit të vitit 2001⁷, megjithatë, përfaqësimi politik, diskriminimi dhe sfidat ekonomike mbeten probleme të vazhdueshme të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut.

Figure 1. Popullsia e Maqedonisë së Veriut



Burimi: Census 2021

⁷ Enti shtetëror për statistikë. (2021).

https://www.stat.gov.mk/ZaNas_al.aspx

Tabela.1 Komuniteti shqiptar në Maqedoninë e Veriut (1981-2021)

Viti	Nr. i Shqiptarëve ne RMV	Përqindja
1981	377,726	19.8
1994	441,987	22.9
2002	509,083	25.1
2021	446,245	24.3

Burimi: Census

3.2. Shqiptarët në Mal të Zi

Komuniteti shqiptar në Mal të Zi, sipas censusit të vitit 2011, përbënte 4.96% të popullsisë, (Figura.2) dhe pritet që me paraqitjen e të dhënave të censusit të vitit 2023, numri i shqiptarëve të jetë mbi 5.6%. Numri i shqiptarëve në Mal të Zi ka ardhur në rënie nga 1991 për shak të dhunës dhe diskriminimit ndaj komunitetit shqiptarë në këto vite. (Tabela.2) Shumica e shqiptarëve jetojnë në Ulqin dhe Tuz, por ka përqindje të konsiderueshme edhe në Guci, Plavë, Podgoricë, Tivar dhe Rozhajë.


Figura 2. Popullsia e Malit të Zi**Burimi: Census 2011**

Tabela.2 Komuniteti shqiptar në Mal të Zi

Viti	Nr. i Shqiptarëve ⁸ ne MZ	Përqindje
1948	19,425	5.1
1953	23,460	5.6
1961	25,803	5.5
1971	35,671	6.7
1981	37,735	6.5
1991	40,415	6.6
2003	31,163	5.0
2011	30,439	4.9


Burimi: Census

3.3. Shqiptarët në Serbi

Sipas të dhënave të fundit nga censusi i vitit 2022, shqiptarët përbëjnë rreth 0.9% të popullsisë së përgjithshme në Serbi. Përqëndrimet kryesore të shqiptarëve janë në Luginën e Preshevës, përfshirë komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës.⁹ Numri i shqiptarëve në vite ka përbërë 1% (Tabela nr.3) të popullsisë, megjithatë përfaqësues të komunitetit deklarojnë se shifrat janë më të larta, por manipulohen nga shteti serb.

⁸ Made in Montenegro. (2011). Demografia e Malit të Zi. (<https://web.archive.org/web/20110513040804/http://www.madeinmontenegro.com/vbforum/archive/index.php/t-4043.html>)

⁹ Census (2022), ABOUT CENSUS. (n.d.). <https://popis2022.stat.gov.rs/en-us/popisni-podaci-eksel-tabele/>

Figure 3. Popullsia e Serbisë**Burimi: Census 2022****Tabela.3 Komuniteti shqiptar në Serbi**

Census	Nr. i Shqiptareve në Serbi	Përqindja
1948	33,769	0,6%
1953	40,954	0.7%
1961	53,167	0.8%
1971	68,539	1%
1981	76,296	1%
1981	78,281	1%
2002	61,647	0.8%
2011 ¹⁰	5,809	0.1%
2022	61,687	0.9%

Burimi: Census¹⁰Shqiptarët nuk morën pjesë në regjistrimin e popullsisë në vitin 2011.

4. Sfidat që përballet komuniteti shqiptar

Shqiptarët në disa vende të Ballkanit përballen me sfida në ruajtjen e identitetit të tyre kombëtar, kulturor dhe gjuhësor. Kjo është veçanërisht e vërtetë për komunitetet në Serbi, Mal të Zi dhe Maqedoni të Veriut, ku politikat e asimilimit dhe diskriminimi ndikojnë në ruajtjen e identitetit shqiptar.

Diskriminimi dhe të drejtat e njeriut: Shqiptarët shpesh përballen me diskriminim dhe kufizime të të drejtave të tyre civile dhe politike. Kjo përfshin mungesën e përfaqësimit adekuat në institucione shtetërore, përjashtimin nga mundësitë ekonomike dhe edukative dhe trajtimin e padrejtë në sistemin e drejtësisë.

Problemet ekonomike: Rajonet me shumicë shqiptare shpesh janë ndër më të varftrat dhe më pak të zhvilluara ekonomikisht. Kjo ndikon në papunësi të lartë, mungesë investimesh, mungesë zhvillimi të infrastrukturës dhe migracion të lartë të popullsisë, veçanërisht të të rinjve.

Ndërrhyrjet politike dhe ndërlikimet ndërkombëtare: Çështjet shqiptare shpesh bëhen pjesë e politikave të brendshme dhe të jashtme të vendeve të Ballkanit, duke krijuar tensione ndëretnike dhe ndërshtetërore. Kjo ndikon në stabilitetin politik dhe social në rajon.

Mungesa e bashkëpunimit dhe solidaritetit ndërshtetëror: Megjithëse ka përpjekje për bashkëpunim ndërmjet shqiptarëve në rajon, shpesh mungojnë iniciativa të bashkërenduara që mund të forcojnë pozitën e tyre kolektive në Ballkan. Kjo përfshin bashkëpunimin ekonomik, politik dhe kulturor.

Edukimi dhe gjuhësimi: Në disa rajone, shqiptarët kanë vështirësi për të pasur qasje në arsim në gjuhën e tyre amtare dhe për të ruajtur gjuhën shqipe në institucionet arsimore. Kjo ndikon në arsimimin e fëmijëve dhe në ruajtjen e gjuhës dhe kulturës shqiptare.

Më poshtë do të analizojmë sfidat që përballen komunitetet shqiptare në shtetet e Ballkanit Perëndimor.

4.1. Komuniteti shqiptar në RMV

Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut kanë bërë hapa të rëndësishëm në pjesëmarrjen politike në këtë vend, por ende përballen me sfida të mëdha.

Së pari mbetet pabarazia ekonomike midis rajoneve ku jetojnë shqiptarët dhe maqedonasit e cila reflektohet nëpërmjet disa faktorë dhe tregues të rëndësishëm ekonomikë. Këto përfshijnë Prodhimin e Brendshëm Bruto (BPB) për banorë, nivelin e papunësisë, investimet dhe qasjen në shërbime publike dhe infrastrukturore. Rajoni i Pollogut, ku është e përfshirë Tetova, Gostivari dhe komuna tjera rurale me shumicë shqiptare, përballlet me një Prodhim të Brendshëm Bruto (BPB) për banorë shumë më të ulët në krahasim me rajonin e Shkupit dhe rajonin Lindor. Në rajonin e Pollogut gjatë vitit 2023 ishte 3.429 euro derisa në rajonin e Shkupit si kryeqytet ishte 8.603 euro dhe në rajonin Lindor, ku janë pjesë dërmuese maqedonase 6.593 euro. Rajonet me shumicë shqiptare janë ndër më të varfrat dhe më pak të zhvilluara ekonomikisht. Kjo çon në papunësi të lartë, mungesë investimesh dhe migracion të lartë të të rinjve. Shkalla e papunësisë në këto rajone është katër herë më e lartë se në rajonet ku jetojnë maqedonasit. Në rajonin Verilindor, papunësia ka arritur në shifra alarmante prej 31.8%, në krahasim me rajonin Juglindor ku është vetëm 4.5%. Kjo tregon një hendek të jashtëzakonshëm pabarazie. (Tabela nr.4) Pra kemi një mosbalancë mes zhvillimeve të rajoneve, ku jetojnë shqiptarët dhe maqedonasit.

Tabela.4 Zhvillimi ekonomik sipas rajoneve në Maqedoninë e Veriut

Rajoni ¹¹	Rroga Mesatare Neto (€/muaj)	PBB për Banor (€/vit)	Shkalla e Papunësisë (%)
Shkup	586	8,603	4,8
Verilindor	421	3,719	31.8
Juglindor	424	6,804	4.5
Lindor	439	6,539	5.4
Pollog	463	3,429	-
Vardar	429	6,664	-
Pellagoni	464	5,909	-
Jugperendimor	474	5,792	-

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës së Republikës së Maqedonisë së Veriut

“Së dyti kemi problemet me gjuhën shqipe dhe arsimin.” Sipas legjislacionit ekzistues, gjuhët e pakicave etnike duhet të njihen si gjuhë zyrtare shtesë në zonat ku këto pakica përbëjnë të paktën 20% të popullsisë. Në ato zona, qytetarët kanë të drejtën të komunikojnë me zyrat lokale të qeverisë qendrore në gjuhën e grupit të pakicës dhe të marrin përgjigje dhe dokumente personale në të njëjtën gjuhë; megjithatë, kjo nuk ndodh gjithmonë në praktikë.¹² Legjislacioni parashikon arsimin fillor dhe të mesëm në gjuhët e pakicave etnike. Arsimi fillor është i disponueshëm në maqedonisht, shqip, turqisht dhe serbisht.¹³ Megjithatë, shqiptarët tregojnë se shpërndarja e burimeve

¹¹ Enti Shtetëror i Statistikës së Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2024). Të dhënat e tregut të punës.

https://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/en/MakStat/MakStat_PazarNaTrud_TrimesecniARS/

¹² Wolff, S. (2008). *Minority Rights in Western Balkans*. Marrë nga <https://stefanwolff.com/wp-content/uploads/2008/06/MRWB.pdf>

¹³North Macedonia - United States Department of State. (2023, December 7). United States Department of State. <https://www.state.gov/reports/2022-country-reports-on-human-rights-practices/north-macedonia/>

publike arsimore nuk është proporcionale me përfaqësimin e grupeve etnike brenda popullsisë së përgjithshme.

Sipas ligjeve ekzistuese, të gjitha grupet etnike duhet të jenë në gjendje të përdorin libra shkollorë në gjuhën e tyre amtare. Në praktikë, ka pak financim për të siguruar materialet e nevojshme. Shkollat me mësim në gjuhën shqipe, veçanërisht ato të qytetit, punojnë në kushte shumë të vështira (sidomos në lidhje me mungesën e hapësirës).

Gjendja e shkollave shqipe në Maqedoninë e Veriut është shqetësuese, duke përfshirë mungesën e kushteve elementare për një arsim cilësor. Për shembull, në Shkollën e Mesme Gjimnazi "Sami Frashëri" në Kumanovë, nxënësit mësojnë në ish-zyrat e një fabrike "ZIK". Në shkollën e mesme të mjekësisë "Nace Bugjoni" në Kumanovë, nxënësit mësojnë në kontejnerë.¹⁴ Problemet vazhdojnë edhe në shkollat e tjera në qytetet e ndryshme, ku mungojnë pajisje themelore për zhvillimin e një arsimi cilësor. Librat në gjuhën shqipe për shkollën fillore dhe gjimnazistët janë në gjendje të mjerueshme, me përkthime të dobëta nga maqedonishtja që nuk janë të përshtatura siç duhet. Mungesa e çerdheve për fëmijët shqiptarë në Kumanovë është një problem që ka ndikuar negativisht në shumë familje. Aktualisht, ekziston vetëm një çerdhe që i shërben komunitetit shqiptar dhe kjo nuk është e mjaftueshme për të plotësuar nevojat në rritje.¹⁵ Për këto problema nuk është mbajtur asnjë qëndrim nga pala shqiptare apo nga Ambasada shqiptare në Shkup.

4.2. Komuniteti shqiptar në Mal të Zi

Së pari janë problemet ekonomike ku në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH) theksohet se shqiptarët dhe boshnjakët në pjesët jugore dhe verilindore të vendit pohojnë se janë viktimat të

¹⁴ Intervist me Zenel Miftari gazetarë në RMV

¹⁵ Koha. (2023, June 23). *S'ka çerdhe për fëmijët shqiptarë në Kumanovë!* - KOHA. KOHA. <https://koha.mk/ska-cerdhe-per-femijet-shqiptare-ne-kumanove/>

diskriminimit nga qeveria dhe kanë argumentuar se vuajnë nga neglizhenca ekonomike.¹⁶ Këto grupe etnike ndihen të anashkaluara dhe të përjashtuara nga politikat dhe investimet qeveritare, ç'ka ndikon negativisht në zhvillimin e tyre ekonomik dhe social. Trevat ku jetojnë shqiptarët në Mal të Zi, megjithëse të pasura me burime natyrore si plazhet dhe tokat bujqësore, mbeten të pazhvilluara në krahasim me zonat e tjera të vendit. Një nga sfidat kryesore është nevoja për të përmirësuar statusin e tyre në shoqëri, duke krijuar kushte që komuniteti shqiptar të mund të zhvillojë dhe shfrytëzojë resurset e tyre në mënyrë të plotë.

Pavarësisht potencialit të tyre, këto zona vuajnë nga mungesa e investimeve dhe mbështetjes qeveritare, duke penguar zhvillimin ekonomik dhe social të komunitetit shqiptar.

Së dyti janë problemet në arsimin në gjuhën shqipe, siç janë përdorimi i librave të përkthyer nga serbishtja dhe mungesa e hapësirës për historinë dhe kulturën shqiptare në mësimet (2.5% në shkollat fillore dhe 5.9% në shkollat e mesme), si dhe tensionet rreth themelimit të trajnimeve për mësues në gjuhën shqipe, janë sfida themelore për komunitetin shqiptar në arsimin në Mal të Zi. Këto çështje shkaktojnë vështirësi në forcimin e lidhjeve kulturore dhe identitare të komunitetit.¹⁷ Në bazë të vëzhgimeve dhe intervistave të zhvilluara¹⁸ konstatuam probleme mbi çështjen e braktisjes së gjuhës shqipe dhe mosdeklarimit si shqiptarë për shkak të përfitimeve sociale. Kjo tregon nevojën për

¹⁶ Montenegro - United States Department of State. (2024, April 22). United States Department of State. <https://www.state.gov/reports/2023-country-reports-on-human-rights-practices/montenegro/>

¹⁷ Wolff, S. (2008). *Minority Rights in Western Balkans*. Marrë nga <https://stefanwolff.com/wp-content/uploads/2008/06/MRWB.pdf>

¹⁸ Intervista me Nikolle Camaj, deputet të komunitetit shqiptar në Parlamentin e Malit të Zi.

masa që të mbrohen dhe promovohen vlerat kulturore dhe gjuhësore të komunitetit shqiptar në Mal të Zi.¹⁹

Së treti, sigurimi i përfaqësimit të barabartë të shqiptarëve në institucione është kritik për garantimin e të drejtave të tyre kushtetuese dhe përforcimin e rolit të tyre në shoqëri.

4.3. Komuniteti shqiptar në Serbi

Problemi i pasivizimit të adresave në komunitetin shqiptar të Serbisë është një çështje e rëndësishme dhe e ndjeshme, e cila ka shkaktuar shqetësime të mëdha dhe kritika nga komuniteti ndërkombëtar dhe organizatat për të drejtat e njeriut. Ky proces i pasivizimit ka përdorur nenin 18 të ligjit për qëndrimin në Serbi për të larguar shqiptarët nga regjistri civil nëse ata nuk konstatohen në adresën e tyre të regjistruar gjatë kontrollit, duke i dënuar ata me humbjen e shumë të drejtave bazë si të drejtën për të votuar, për të regjistruar makinën, për të patur akses në shërbime shëndetësore dhe sociale, si dhe për të blerë ose shitur pronë. Sipas një raporti të vitit 2021 nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, zbatimi joproporcional i këtij ligji nga qeveria që synonte shqiptarët, përbënte "spastrimin etnik përmes mjeteve administrative".²⁰

Medvegja është zona më prekur nga pasivizimi, ku raportohet se mbi 3,000 adresa janë pasivizuar në Medvegjë dhe mbi 2,000 në Preshevë e Bujanovc.²¹

¹⁹ Kreu i Këshillit Shqiptar në Malin e Zi: Komuniteti ynë përballet me probleme të mëdha, preferojnë të mos e deklarojnë etninë! Politika Abazoviç nuk ka lidhje me shqiptarët. (2022, April 29). Shqiptarja.com. <https://shqiptarja.com/lajm/kreu-i-keshillit-shqiptar-ne-malin-e-zi-shqiptaret-perballen-me-probleme-te-medha-preferojne-te-mos-deklarohen-si-te-tille-abazovic-ka-ende-pune-per-te-bere-po-cenohet-trashegimia>

²⁰ Serbia - United States Department of State. (2023, December 7). United States Department of State. <https://www.state.gov/reports/2022-country-reports-on-human-rights-practices/serbia>

²¹ Intervista me Shaip Kamberi, deputet të komunitetit shqiptar në Parlamentin Serb.

Në rastin e Medvegjës, për shembull, ka shqiptarë që raportojnë se u janë fshirë adresat pa dijeninë e tyre dhe pas kohës kur ata kishin tentuar të rinovonin dokumentet e tyre të identitetit. Kjo ka pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në përfaqësimin politik të komunitetit shqiptar në nivel lokal, duke u zvogëluar numrin e këshilltarëve të tyre në kuvendet komunale.

Ky proces është cilësuar si diskriminues dhe si përpjekje për spastrim etnik, duke pasqyruar një shkelje të drejtave themelore dhe ligjit për minoritetet në Serbi. Institucionet dhe liderët evropianë kanë bërë thirrje për hetime të pavarura dhe të plotë mbi këto akuza dhe kanë kërkuar që autoritetet serbe të ndalojnë praktikat diskriminuese.²²

Së dyti komuniteti shqiptar në Serbi përballlet me probleme të mëdha në fushën e arsimit, sipas ligjit, pakicat etnike kanë të drejtë të arsimohen në gjuhën e tyre të pakicës, por kjo e drejtë nuk është respektuar ndaj komunitetit shqiptar në Serbi. Nuk ka tekste në gjuhën shqipe në dispozicion për nxënësit e shkollave të mesme, edhe pse shqiptarët etnikë vlerësohen të jenë një nga pesë grupet më të mëdha minoritare në vend. Kjo shkelje e ligjit ka pasur një ndikim negativ në aftësimin dhe identitetin e kulturës së tyre në sistemin arsimor serb.

Në ndarjen e buxhetit të shtetit serb për fushën e arsimit 5.3 milionë euro për vitin 2023 nuk u dha asnjë cent për shkollat e komunitetit shqiptar, një formë e hapur diskriminimi. Kjo mungesë e përkushtimit financiar ka pasur një ndikim negativ në mundësitë e shkollimit dhe zhvillimin e arsimit për shqiptarët në Serbi.

Në anën tjetër, qeveria shqiptare nuk ka reaguar ndaj këtij problemi. Në vitin 2020, Qeveria shqiptare dhuroi 40 mijë euro për Këshillin Kombëtar Shqiptar në Serbi për të mbështetur arsimin. Megjithatë, që prej 4 vitesh, nuk ka pasur një mbështetje të re nga ana e qeverisë shqiptare për këtë çështje, duke lënë pa mbrojtje financiare dhe

²² Serbia 2023 report. (2023). SWD(2023) 695 final. EUROPEAN COMMISSION. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/serbia-report-2023_en

institucionale komunitetin shqiptar në Serbi në lidhje me nevojat e tyre arsimore.

Të gjitha këto probleme kanë çuar në uljen e numrit të nxënësve në shkollat e komunitetit shqiptar, ashtu siç është paraqitur në tabelën më poshtë. Situata është shqetësuese për shkak të një reduktimi alarmant të shifrave ulje mbi 50% brenda 10 viteve. (Tabela. 5)

Tabela.5 Mbi numrin e nxënësve në shkollat shqipe

Komuna	Shkolla	2020	2021
Bujanoc	Migjeni, Muhoc	246	90
	Muharrem Kadriu	1,150	467
	Ali Bektashi	441	177
	Desanka Maksimoviq	529	235
	Sami Fasheri	462	214
	Naim Frasheri	473	401
Preshevë	Dituria	402	198
	9 Maji	551	220
	Selami Hallaci	534	295
	Migjeni, Caravajke	83	38
	Zenel Hajdini,Raince	289	254
	Ibrahim Klemendi	2,035	1,347
Medvegjë	Zenel Hajdini,Tupalle	21	13

Burimi: Nga intervistat e zhvilluara

Së treti shqiptarët etnikë ishin subjekt i diskriminimit dhe papunësisë disproporcionale. Udhëheqësit shqiptarë etnikë në komunat jugore të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit së bashku me boshnjakët në rajonin jugperëndimor të Sanxhakut vazhduan të shprehin shqetësimin për

nënpërfaqësimin e komuniteteve të tyre në institucionet shtetërore në nivel lokal. Sipas raportit të DASH thuhet se shqiptarët etnikë kanë vazhduar të diskriminohen në punësim dhe punësim në institucionet publike dhe private.²³

Së fundimi komuniteti shqiptar po përballlet me një problem kyc në lidhje me financimin Këshillit Kombëtar Shqiptar²⁴.

Vendimi i qeverisë së Serbisë për të ulur buxhetin e Këshillit Kombëtar Shqiptar (KKSH) me mbi 1 milion dinarë për vitin 2024 ka shkaktuar një shqetësim të thellë. Në vend që të pritej një rritje e financimit pas regjistrimit të popullsisë, kjo masë përbën një shkelje të ligjeve për mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve dhe standardeve ndërkombëtare. Ky veprim dëshmon për një diskriminim të vazhdueshëm të Serbisë ndaj komunitetit shqiptar dhe do të ketë ndikim negativ në veprimtarinë e KKSH-së dhe në mirëqenien e minoritetit shqiptar në Serbi.

Ndërkohë, qeveria e Republikës së Kosovës ka reaguar menjëherë duke premtuar rritjen e buxhetit për KKSH në 3 milion euro për vitin 2024. Nga ana tjetër, qeveria shqiptare nuk ka marrë një qëndrim publik për këtë çështje, nuk e ka ngritur problemin në instancat ndërkombëtare dhe as nuk ka bërë publike shifrat konkrete të buxhetit të saj për KKSH.²⁵

Për më tepër, pavarësisht kërkesave tona drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ) dhe Agjencisë së Diasporës, nuk kemi marrë asnjë përgjigje konkrete lidhur me financimin nga qeveria shqiptare për KKSH dhe komunitetet tona në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Nga kërkimet që kemi kryer, rezulton se buxheti për KKSH

²³ Serbia - United States Department of State. (2023, December 7). United States Department of State. <https://www.state.gov/reports/2022-country-reports-on-human-rights-practices/serbia>

²⁴Këshilli Kombëtar Shqiptar në Serbi është institucioni kryesor përfaqësues i shqiptarëve

²⁵ Rashiti, V. (2024, February 5). *Lutfiu: Serbia e ka ulur buxhetin për KKSH-në për mbi 1 milion dinarë*. Albanian Post. <https://albanianpost.com/lutfiu-serbia-e-ka-ulur-buxhetin-per-kksh-ne-per-mbi-1-milion-dinare/>

nga MEPJ ishte 3,700 euro në vitin 2019 dhe 8,700 euro në vitin 2020,²⁶ shifra këto që janë të pamjaftueshme për të përballuar sfidat e mëdha që ky komunitet përballlet çdo ditë në ruajtjen e gjuhës, kombësisë dhe identitetit të tij.

5. Roli i Shtetit Shqiptar në Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave dhe Identitetit Shqiptar në Rajon

Shteti shqiptar ka një rol të rëndësishëm në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të shqiptarëve në rajon. Ky rol përfshin diplomacinë aktive, mbështetjen e organizatave shqiptare në diasporë dhe ndihmën për ruajtjen e identitetit kulturor dhe gjuhësor. Megjithatë, përkundër faktit se qeveri të ndryshme në Shqipëri kanë shfaqur tendenca për të përdorur çështjen e shqiptarëve në shtetet fqinje për përfitime të brendshme politike, sot ndikimi i Shqipërisë mbi shqiptarët në Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi është më shumë simbolike sesa reale.

Në këtë kontekst, roli i qeverive shqiptare dhe MEPJ-se ka qenë shpesh i pamjaftueshëm. Ndërkohë që pritej që shteti amë të luante një rol aktiv në mbrojtjen dhe mbështetjen e këtyre komuniteteve, realiteti ka treguar se çështja shqiptare është përdorur më shumë për qëllime politike sesa për të ndihmuar realisht komunitetet shqiptare jashtë kufijve. Shumë qeveri shqiptare kanë përdorur retorikën nacionaliste për të fituar vota dhe për të fituar simpati, por kanë dështuar të ndërmarrin veprime konkrete dhe efikase.

Çështjet e shqiptarëve në Serbi, Mal të Zi dhe Maqedoni të Veriut shpesh janë trajtuar me indiferencë ose me masa të pamjaftueshme. Ndërkohë që këto komunitete kanë nevojë për mbështetje konkrete në formën e financimeve për arsim, kulturë dhe zhvillim ekonomik, qeveritë shqiptare rrallëherë kanë siguruar fonde dhe ndihmë të qëndrueshme.

Një shembull konkret i kësaj neglizhence është çështja e pasivizimit të adresave të shqiptarëve në Serbi. Kjo praktikë diskriminuese ka krijuar

²⁶ MEPJ. VKM. Nr. 717 date 16.09.2020

një klimë pasigurie dhe marginalizimi, duke rritur varfërinë dhe përkeqësuar kushtet e jetesës për shumë familje shqiptare.

Pavarësisht kësaj situatë alarmante, reagimet nga qeveria shqiptare kanë qenë të vakta dhe të pamjaftueshme. Ndërkohë që pritej një reagim i fortë diplomatik dhe ngritja e kësaj çështjeje në forume ndërkombëtare, qeveria shqiptare ka dështuar të ndërmarrë hapa konkrete për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve të saj në Serbi.

Nga analiza jonë, kuptojmë se shteti shqiptar ka mbajtur një rol pasiv dhe nuk ka ndërhyrë në punët e brendshme të shteteve të Ballkanit Perëndimor për të mbrojtur bashkëkombasit e tij. Nga viti 2014 deri në 2018 pati një përpjekje për të bashkëpunuar me Kosovën në lidhje me komunitetet shqiptare, por në vitet e fundit kemi parë një ftohje të marrëdhënieve bilaterale midis dy vendeve. Kjo situatë reflektohet edhe në lënien pas dore të çështjeve të komuniteteve shqiptare në rajon.



2. PËRFUNDIMET

Raporti mbi gjendjen e komunitetit shqiptar në Ballkanin Perëndimor tregon qartë se ky komunitet përballet me sfida të mëdha dhe të ndërlikuara që kërkojnë zgjidhje të integruara dhe të koordinuara. Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbi vazhdojnë të luftojnë për njohjen dhe respektimin e të drejtave të tyre etnike, kulturore dhe gjuhësore, përballë diskriminimit dhe politikave asimiluese.

Në Maqedoninë e Veriut, shqiptarët përbëjnë 24.3% sipas Censit të vitit 2021 dhe ky numër ka ardhur në rritje që nga viti 1981. Komuniteti shqiptar në Mal të Zi, sipas censusit të vitit 2011, përbënte 4.96% të popullsisë dhe pritet që me paraqitjen e të dhënave të censusit të vitit 2023, numri i shqiptarëve të jetë mbi 5.6%. Sipas të dhënave të fundit nga censusi i vitit 2022, shqiptarët përbëjnë rreth 0.61% të popullsisë së përgjithshme në Serbi.

Komuniteti shqiptar në rajon përballet me sfida të shumta, por gjithashtu ka arritur disa përparime të rëndësishme. Angazhimi i shtetit shqiptar dhe mbështetja ndërkombëtare janë thelbësore për përmirësimin e kushteve të tyre dhe ruajtjen e identitetit të tyre, por me mbështetjen e duhur nga shtetet respektive dhe nga shteti shqiptar, është e mundur të arrihen përmirësime të rëndësishme në gjendjen e tyre. Zbatimi i rekomandimeve të përmendura më sipër mund të ndihmojë në krijimin e një mjedisi më të drejtë dhe më të barabartë për shqiptarët në rajon.

3. REKOMANDIMET

- 1- Është e domosdoshme që qeveritë e Shqipërisë dhe Kosovës të bashkëpunojnë ngushtë dhe të zhvillojnë një strategji të përbashkët për mbrojtjen dhe mbështetjen e shqiptarëve jashtë kufijve të tyre. Ky bashkëpunim duhet të përfshijë veprime diplomatike të koordinuara, ngritjen e çështjeve të të drejtave të njeriut në forume ndërkombëtare dhe sigurimin e fondeve të qëndrueshme për zhvillimin ekonomik, arsimor dhe kulturor të këtyre komuniteteve.
- 2- Të sigurohet që në të gjitha shkollat me mësim në gjuhën shqipe, të ketë një program të standardizuar dhe të cilësisë së lartë që reflekton kulturën, historinë dhe vlerat kombëtare shqiptare. Kjo përfshin trajnimin e mësuesve, furnizimin me materiale mësimore adekuate dhe organizimin e aktiviteteve kulturore dhe arsimore që forcojnë identitetin shqiptar.
- 3- Hapjen e disa qendrave kulturore shqiptare me qëllim shkëmbimet studentore dhe të nxënësve për të rritur dhe kultivuar kulturën e përbashkët dhe kështu me radhë
- 4- Krijimi i një platforme online për komunitetet shqiptare jashtë vendit, ku ata mund të ndajnë lajme, resurse edukative dhe kulturore dhe të organizojnë aktivitete dhe projekte të përbashkëta. Kjo do të ndihmojë në lidhjen e shqiptarëve dhe në përforcimin e solidaritetit ndërmjet tyre.
- 5- Promovimi i bashkëpunimit ekonomik ndërmjet biznesmenëve dhe sipërmarrësve shqiptarë në rajon, duke krijuar rrjete biznesi dhe forume ekonomike që inkurajojnë investimet dhe zhvillimin ekonomik brenda komunitetit.
- 6- Organizimi i konferencave dhe seminareve ndërkombëtare për të ngritur vetëdijen mbi çështjet që prekin komunitetin shqiptar në Serbi, Mal të Zi dhe Maqedoni të Veriut. Këto ngjarje mund të shërbejnë si platforma për të adresuar sfidat dhe për të propozuar zgjidhje praktike.
- 7- Lobimi pranë organizatave ndërkombëtare, si Bashkimi Evropian, Kombet e Bashkuara dhe organizatat e të drejtave të njeriut, për të siguruar që çështjet e komunitetit shqiptar të jenë pjesë e agjendave të tyre dhe të marrin mbështetjen e nevojshme.

6. REFERENCAT

- Census (2022) ABOUT CENSUS. (n.d.). <https://popis2022.stat.gov.rs/en-us/popisni-podaci-eksel-tabele/>
- Censusi i ri/ Rritet numri i shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, ja sa banorë ka Shkupi! Ali Ahmeti: Pasqyra më e mirë. (2022, March 30). *Gazeta Shqip*. <https://gazeta-shqip.com/bota/censusi-i-ritet-numri-i-shqiptareve-ne-maqedonine-e-veriut-ja-sa-banore-i1174133/>
- Dauti, N. (2023, June 30). RMV, shqiptarët përjetonë stres shumë më të madh nga problemet ligjore krahasuar me maqedonasit dhe etnitë e tjera. *Portalb*. <https://portalb.mk/rmv-shqiptaret-perjetone-stres-shume-me-te-madh-nga-problemet-ligjore-krahasuar-me-maqedonasit-dhe-etnite-e-tjera/>
- Document of the Copenhagen Meeting of the Conference on the Human Dimension of the CSCE. (n.d.). OSCE. <https://www.osce.org/odihr/elections/14304>
- Enti shtetëror për statistikë. (n.d.). https://www.stat.gov.mk/ZaNas_al.aspx
- Francesco Capotorti, Study on the rights of persons belonging to ethnic, religious, and linguistic minorities (UN Doc. E/CN.4/Sub.2/384/Rev.1, 1979).
- Kadriu, I. (2022, October 29). Shqiptarët kërkojnë të hiqet përkufizimi në Kushtetutë si popull "20%." *Radio Evropa E Lirë*. <https://www.evropaelire.org/a/shqiptaret-maqedoni-kushtetuta-ndryshimi-20perqind-/32106053.html>
- Keshilli i Ministrave. (2018). STRATEGJIA KOMBETARE E DIASPORES 2018 - 2024 DHE PLANI I VEPRIMIT. In *Chrome-extension://Efaidnbmnnnibpcajpcgiclfndmkaj/https://punetej-ashtme.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/strategjia-kombetare-e-diaspores-2018-2024-dhe-plani-i-veprimit.pdf*.
- Koha. (2023, June 23). S'ka çerdhe për fëmijët shqiptarë në Kumanovë! - KOHA. KOHA. <https://koha.mk/ska-cerdhe-per-femijet-shqiptare-ne-kumanove/>

- Krasniqi, G. (2011). Citizenship in an Emigrant Nation-State: the case of Albania. *Social Science Research Network*.
<https://doi.org/10.2139/ssrn.1914412>
- Kreu i Këshillit Shqiptar në Malin e Zi: Komuniteti ynë përballet me probleme të mëdha, preferojnë të mos e deklarojnë etninë!* *Politika Abazoviç nuk ka lidhje me shqiptarët*. (2022, April 29). Shqiptarja.com. <https://shqiptarja.com/lajm/kreu-i-keshillit-shqiptar-ne-malin-e-zi-shqiptaret-perballen-me-probleme-te-medha-preferojne-te-mos-deklarohen-si-te-tille-abazovic-ka-ende-pune-per-te-bere-po-cenohet-trashegimia>
- Ministria e Arsimit dhe Shkencës. (2001). Marrëveshja e Ohrit.
https://mls.gov.mk/images/laws/Marreveshja_e_Ohrit.pdf
- Montenegro - *United States Department of State*. (2024, April 22). United States Department of State.
<https://www.state.gov/reports/2023-country-reports-on-human-rights-practices/montenegro/>
- North Macedonia - *United States Department of State*. (2023, December 7). United States Department of State.
<https://www.state.gov/reports/2022-country-reports-on-human-rights-practices/north-macedonia/>
- Rashiti, V. (2024, February 5). *Lutfiu: Serbia e ka ulur buxhetin për KKSH-në për mbi 1 milion dinarë*. Albanian Post.
<https://albanianpost.com/lutfiu-serbia-e-ka-ulur-buxhetin-per-kksh-ne-per-mbi-1-milion-dinare/>
- Serbia - *United States Department of State*. (2023, December 7). United States Department of State.
<https://www.state.gov/reports/2022-country-reports-on-human-rights-practices/serbia>
- Serbia 2023 report. (2023). In SWD_2023_695_Serbia (SWD(2023) 695 final). EUROPEAN COMMISSION. https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/serbia-report-2023_en

#QËNDRESË MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NED

MINISTRJA
E PUNËVE
DHE QYTETARE

EUROPEAN RESEARCH AND INNOVATION

www.qeverisja.qg.com.al